



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI**

Nr. 800/1 Prot.

Tiranë, më 28.05.2026

**V E N D I M**

**Nr.142, Datë 28.05. 2026**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar<sup>1</sup>, mori në shqyrtim ankesën nr.106 Regj., datë 23.04.2026, të z. K.L kundër Bashkisë Shkodër dhe Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” Shkodër, në të cilën pretendon diskriminimin e vajzës së tij të mitur N.L për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit ankuesi K.L, prind dhe përfaqësues ligjor i të miturës N.L , pretendon se vajza e tij, fëmijë në spektrin autik, ka qenë subjekt i trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues në lidhje me përjashtimin e saj nga Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë, Edicioni i 64-të, Shkodër. Pretendimi kryesor nuk kufizohet vetëm në rezultatin e mospërfshirjes, por shtrihet edhe në sjelljen institucionale. Ankuesi pretendon se institucionet e vëna në dijeni kanë dështuar të japin përgjigje të arsyetuar, të ndërmarrin masa korigjuese dhe të garantojnë trajtim të barabartë, duke e shndërruar mosveprimin administrativ në burim të vetë diskriminimit.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimit të verifikojë sjelljen institucionale të autoriteteve të vëna në dijeni, të ndërmarrë masa të menjëhershme për parandalimin e konsumimit të mëtejshëm të pasojës diskriminuese, dhe të urdhërojë masa konkrete riparuese që të garantojnë pjesëmarrjen e të miturës në festival në kushte të barabarta, të gjitha këto në

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

mbështetje të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe në funksion të interesit më të lartë të fëmijës.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i LMD, përcakton se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *"Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".*

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

- Faktet dhe rrethanat.

Bazuar në parashtrimet dhe provat e depozituara nga pala ankuese, rezulton se:

Ankuesi K.L është babai i fëmijës N.L , e datëlindjes 21.08.2023. Rezulton se vajza e ankuesit, është vlerësuar si fëmijë me aftësi të kufizuara nga komisioni shumëdisiplinor i aftësisë së kufizuar.

Në datën 06.03.2026, ankuesi ka aplikuar për pjesëmarrjen vajzës së tij N.L në duet me K.I për Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë Edicioni 64-të Shkodër, me këngën titulluar “Ëndrra Mu Zgjuar”.Ky aplikim është dërguar nëpërmjet e-mailit në adresat zyrtare të Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” dhe Bashkisë Shkodër.

Rezulton se ky aplikim nuk është përzgjedhur për të marrë pjesë në Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë, Edicioni i 64-të, Shkodër. Në këto kushte, në datën 18.03.2026, ankuesi i është drejtuar me e-mail Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” dhe Bashkisë Shkodër, me një kërkesë/ankesë për rishqyrtimin e vendimit për mospërzgjedhjen e këngës “Ëndrra Mu Zgjuar”, rivlerësim profesional, objektiv dhe të arsyetuar të saj mbi bazën e kriterëve artistike dhe procedurale të festivalit, përfshirjen e këngës në festival, nëse nga ky rivlerësim rezulton se ajo i

plotëson kriteret e kërkuara dhe një përgjigje me shkrim, ku të pasqyrohen shkaqet e mospërzgjedhjes dhe kriteret e zbatuara në këtë rast.

Në vijim të kërkesës/ankesës së mësipërme, në datën 25.03.2026, ankuesi ka marrë një përgjigje me *e-mail* nga një prej pjesëtarëve të stafit realizues të festivalit/Qendra Kulturore e Fëmijëve Kujtim Alija, Shkodër, ku ndër të tjera parashtrohet se:

*“1. Në këtë fazë të parë, këngët dëgjohen nga një komision i specializuar vetëm me track, pra pa emra krijuesish e solistësh. Ata gjykojnë çdo këngë (75 të tilla për këtë edicion) dhe shumatorja na jep një renditje të të gjithave sipas vlerësimeve.*

*2. Pas firmosjes së vlerësimeve nga çdo anëtar, është stafi realizues, drejtoresha e Festivalit, njëkohësisht drejtoresha e Qendrës Kulturore për Fëmijë “Kujtim Alija”, znj. O.L, udhëheqësi artistik z. R.G dhe unë, validojmë listën sipas emrit të kompozitorit që i përket çdo track. I gjithë ky proces është transparent, e për të kuptuar cili track i përket këngës së z.Barbullushi e çfarë vlerësimi ka marrë, për pasojë sa vende poshtë vizës që caktoi 30 këngë konkurruese për këtë edicion, mjafton që kompozitori i këngës t’i drejtohet znj.Laro e ajo do të vërë në dispozicion këtë informacion. Por e cilësoj, z.Barbullushi, autori i këngës, jo ju. Asnjë prind nuk është subjekt me të cilin festivali ndërvepron në këtë fazë.....”*

Pas marrjes së përgjigjes së mësipërme, në datën 25.03.2026, ankuesi ka paraqitur një kërkesë nëpërmjet *e-mailit* drejtuar Kryetarit të Bashkisë Shkodër, Drejtores së Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” Shkodër dhe Udhëheqësit Artistik të Festivalit Mbarëkombëtar të këngës për Fëmijë Edicioni 64-të Shkodër, nëpërmjet të cilës kërkon rishqyrtimin e menjëhershëm të vendimit për mospërzgjedhjen e këngës, dhënien e informacionit të arsyetuar mbi procesin e vlerësimit dhe përfshirjen e këngës me të cilën ka konkuruar vajza e tij në listën e këngëve pjesëmarrëse në Festival.

Në datën 02.04.2026, ankuesi i është drejtuar sërish subjekteve të sipërcituar, duke kërkuar që në kuadër të Ditës Botërore të ndërgjegjësimit për Autizmin, Bashkia Shkodër të mbajë përgjegjësi institucionale për mosreagimin e pajustificuar ndaj një rasti që prek drejtpërdrejtë një fëmijë të veçantë me ndjeshmëri të lartë emocionale dhe marrjen e masave riparuese duke e përfshirë këngën “Ëndrra mu zgjua” në Festivalin Mbarëkombëtar të këngës për Fëmijë, Edicioni i 64-të, Shkodër.

Ankuesi i është drejtuar Komisionerit me ankesën nr.106, datë 23.04.2026, duke pretenduar diskriminimin e vajzës së tij N.L , për shkak të aftësisë së kufizuar. Sipas ankuesit diskriminimi i pretenduar konsiston në dy momente, *së pari* në rezultatin përfundimtar të mospërfshirjes së këngës në festival dhe *së dyti*, në mënyrën se si është trajtuar i gjithë rasti nga institucionet e vëna në dijeni. Ankuesi pretendon se, mosveprimi institucional nuk paraqitet si një vonesë e zakonshme administrative, por si një sjellje që në pasojat e saj konkrete ka vendosur vajzën e tij në pozitë të pafavorshme në raport me të drejtën e saj për trajtim të barabartë dhe përfshirje efektive.

- Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa "ç" të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *"4. Ankesa nuk pranohet nëse: ... ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;"* Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, bazuar në arsyetimin vijues:

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar se: *"1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive"*.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar : *"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër."*

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *"a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik"*.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përlligjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund

të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>3</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>4</sup>. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”<sup>5</sup>

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme<sup>6</sup>.

LMD (neni 3, pika 1), e përkufizon diskriminimin si *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje

<sup>3</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

<sup>4</sup> Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

<sup>5</sup> Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

<sup>6</sup> Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë *në radhë të parë* se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe *në radhë të dytë* duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Në ankesën objekt shqyrtimi konstatohet se pala ankuese ka pretenduar se vajza e tij N.L është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në referim të nenit 1, të LMD, Komisioneri vlerëson se shkakun e pretenduar nga pala ankuese "aftësia e kufizuar" është një shkak që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Gjithashtu, nga aktet administruara rezulton e provuar se, vajza e ankuesit është vlerësuar si një fëmijë me aftësi të kufizuara bazuar në vlerësimin e Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Sipas nenit 33, pika 4, germa "ç" të LMD, ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim. Ky kriter kërkon të paktën indicie minimale nga të cilat mund të prezumohet një diferencë në trajtim të lidhur me shkakun e mbrojtur, që në këtë rast është aftësia e kufizuar.

Sipas LMD, neni 3, pika 1, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë bazuar në një shkak të mbrojtur. Pra, edhe në fazën e pranueshmërisë, pala ankuese duhet të parashtojë fakte minimale nga të cilat mund të lindë prezumimi se trajtimi i pafavorshëm ka si bazë shkakun e mbrojtur në këtë rast, aftësinë e kufizuar.

Nga faktet dhe rrethanat e parashtruara, si dhe aktet e administruara, rezulton se:

Gjatë procedurave të zhvilluara për përzgjedhjen e këngëve pjesëmarrësve në festival, këngët rezulton se janë dëgjuar nga ana e komisionit të ngarkuar me vlerësimin e këngëve, pa emrat e solistëve apo krijuesve, vetëm me *track* audio. Në këtë mënyrë, vlerësimi i këngëve nga ana e komisionit realizohet pa dijeni për identitetin e interpretuesve. Në asnjë nga faktet e parashtruara nuk rezulton se komisioni apo strukturat e tjera të festivalit, kanë pasur dijeni se vajza e ankuesit është një fëmijë me aftësi të kufizuar. Në këto kushte, mungon plotësisht lidhja shkakore midis aftësisë së kufizuar të vajzës së ankuesit N.L , të pretenduar si shkak diskriminues dhe rezultatit të mospërzgjedhjes. Gjithashtu, pretendimi për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar,

Ankuesi pretendon gjithashtu se mosveprimi institucional, mungesa e reagimit dhe e transparencës pas ankesave, përbën në vetvete diskriminim. Ky pretendim është i pabazuar për këto arsye:

*Së pari*, ankuesi ka marrë përgjigje me e-mail më datë 25.03.2026 ku i janë shpjeguar procedurat e vlerësimit, fakt ky që e relativizon pretendimin e “heshtjes institucionale” dhe *së dyti*, mosveprimi apo vonesa administrative e pretenduar mund të përbëjë shkelje të detyrimeve procedurale administrative, por nuk konsiderohet automatikisht diskriminim sipas LMD nëse nuk lidhet me një shkak të mbrojtur. Minimalisht, për të ngritur një pretendim për diskriminim nëpërmjet mosveprimit, duhet të provohet ose të jepen indicie se institucioni ka trajtuar ndryshe në raste të ngjashme ku fëmijët kanë qenë pa aftësi të kufizuar, gjë e cila nuk është parashtruar dhe pretenduar.

Komisioneri thekson se ky vlerësim nuk përbën dhe nuk duhet të interpretohet si një gjykim mbi meritën artistike të këngës “Ëndrra Mu Zgjua” apo mbi procesin e vlerësimit të festivalit. Objekti i shqyrtimit nga Komisioneri është nëse nga faktet dhe rrethanat e parashtruara rezultojnë indicie të diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar dhe jo vlerësimi i vendimeve artistike apo organizative të subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa nr. 106, datë 23.04.2026 e paraqitur nga z. K.L kundër Bashkisë Shkodër dhe Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” Shkodër, nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme për shqyrtimin e saj, pasi ankesa është haptazi e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr.106 Regj., datë 23.04.2026”, të z. K.L, kundër Bashkisë Shkodër dhe Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” Shkodër, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**

Shkaku: Aftësia e kufizuar  
Fusha: Të mira dhe shërbime  
Lloji i vendimit: Mospranim